



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VAU DEJËS

NJËSIA E MENAXHIMIT TË BURIMEVE NJERËZORE

PROJEKT-VENDIM

Nr. 01 Datë 26.01.2024

PËR

DHËNIEN E SHITESËS MBI PAGË PËR PUNË TË VËSHTIRA E TË DËMSHME PËR SHËNDETIN E PUNONJËSVE PËR VITIN BUXHETOR 2024

Bazuar në nenin 54, pika ç, e Ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, në Ligjin Nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në ligjin Nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në VKM nr 328 datë 31.5.2023 "Për klasifikimin e funksioneve, grupimin e njësive të vetëqeverisjes vendore, për efekt page, dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrative të njësive të vetëqeverisjes vendore", në Vendimin e Këshillit të Bashkisë Vau Dejës nr. 90, datë 21.12.2023, “Për miratimin e nivelit të pagave për funksionarët e zgjedhur e të emëruar, nëpunësit civil dhe punonjësit administrative të Bashkisë Vau Dejës për vitin 2024”, në Urdhërin e Kryetarit të Bashkisë nr.1074, datë 05.12.2023, “Për miratimin e strukturës organizative, organigramën, kategoritë dhe klasat e pagave për cdo pozicion të shërbimit civil dhe administrative për vitin buxhetor 2024”, me propozim të Sektorit të Burimeve Njerëzore, Kryetari i Bashkisë i propozon Këshillit Bashkiak të:

VENDOSË:

1. T’i jepet një shtesë mbi pagë në masën 5000(pesë mijë) lekë në muaj, Z. Denis Shkoza, i punësuar në pozicionin “Përgjegjës i Sektorit të IT”, niveli i diplomës “Bachelor” në degën “Inxhinieri Kompjuterike”, bazuar në pikën 4/b të Vendimit nr. 328, datë 31.5.2023.
2. T’i jepet një shtesë mbi pagë në masën 5000(pesë mijë) lekë në muaj, Z. Sabion Beqiri, i punësuar në pozicionin “Specialist i Sektorit të IT”, niveli i diplomës “Bachelor” në degën “Informatikë”, bazuar në pikën 4/b të Vendimit nr. 328, datë 31.5.2023.
3. Efektet financiare të këtij vendimi fillojnë me datë 01.01.2024.
4. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6 e Ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”.

KRYETARI

Kristian Shkreli

